

Leximet biblike



E hënë, 7 shtator 2020 – Leximet biblike

APOSTULLI – 2 Korinthianëve 12:10-19.

Prandaj kënaqem në dobësira, në fyerje, në nevoja, në përndjekje, në shtrëngime, për Krishtin, sepse kur jam i dobët, atëherë jam i fuqishëm.

U bëra i marrë duke u mburrur; ju më detyruat; sepse unë duhej të rekomandohesha prej jush; sepse në asgjë nuk mbeta prapa nga apostujt më të shquar, ndonëse s'jam gjë. Shenjat e apostullit vepruan tek ju me shumë durim, me çudira, e me shenja, e me fuqira, sepse në ç'punë mbetët prapa nga kishat e tjera, përveç se unë vetë nuk u bëra barrë për ju? Falmani këtë padrejtësi.

Ja e treta herë që jam gati për të ardhur tek ju, edhe nuk dua t'ju bëhem barrë; sepse s'kërkoj pasuritë tuaja, po ju; sepse bijtë s'kanë detyrë të mbledhin për prindërit, po prindërit për bijtë. Por unë me gëzim të madh do të shpenzoj dhe do të shpenzohem fare për shpirtrat tuaj, ndonëse, megjithëse ju dua më tepër, duhem më pak.

Po ashtu qoftë, unë nuk u bëra barrë për ju; po duke qenë dinak, ju zura me dredhi. Mos lakmova gjë prej jush me anë të ndonjërit nga ata që dërgova te ju? Iu luta Titos, edhe bashkë me të dërgova vëllanë. A mos lakmoi gjë prej jush Tito? A nuk ecëm po me atë frymë? A nuk ecëm në po ato gjurmë?

Përsëri pandehni se mbrohem përpara jush? Flasim përpara Perëndisë në Krishtin;

edhe të gjitha këto, o vëllezër, i bëjmë për ndërtimin tuaj.

* * * *

UNGJILLI – Marku 4:10-23

Edhe kur mbeti vetëm, ata që ishin rreth tij bashkë me të dymbëdhjetët e pyetën për paravolinë. Edhe ai u thoshte atyre: Juve ju është dhënë të njihni të fshehtat e mbretërisë së Perëndisë. Po për ata që janë jashtë, të gjitha bëhen me paravoli, që duke parë të vështrojnë, edhe të mos shohin; edhe duke dëgjuar të dëgjojnë, edhe të mos kuptojnë, se mos ndonjëherë kthehen e u falen mëkatet.

Edhe u thotë atyre: Nuk e dini këtë paravoli? Edhe si pra do t'i kuptoni gjithë paravolitë? Mbjellësi është ai që mbjell fjalën. Edhe ata pranë udhës janë këta, në të cilët mbillet fjala; po kur dëgjojnë, përnjëherë vjen Satanai dhe merr fjalën që është mbjellë në zemrat e tyre.

Edhe gjithashtu ata që mbillen në gurishte janë këta, të cilët, kur dëgjojnë fjalën, përnjëherë e marrin me gëzim, po s'kanë rrënjë në veten e tyre, edhe janë për pak kohë. Pastaj, kur bëhet shtrëngim a përndjekje për fjalën, përnjëherë skandalizohen. Edhe ata që mbillen në gjembat janë këta, të cilët e dëgjojnë fjalën, po kujdesjet e kësaj jete dhe gënjimi i pasurisë, edhe dëshirimet për të tjera gjëra, hyjnë e mbysin fjalën, edhe kjo bëhet e pafrytshme.

Dhe ata që u mbollën në dhe të mirë janë këta, të cilët dëgjojnë fjalën dhe e presin, edhe sjellin pemë, një tridhjetë, një gjashtëdhjetë dhe një njëqind.

Edhe u thoshte atyre: Mos vallë sillet kandili që të vihet nën shinik apo nën shtrat? E jo që të vihet mbi kandiler? Sepse s'ka gjë të fshehtë që të mos shfaqet; as nuk është bërë ndonjë gjë e fshehur, që të mos dalë në dukje. Nëse ka ndonjë veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë/facebook](#)